



Bundesministerium
Bildung, Wissenschaft
und Forschung



YEA! Award & Summit 2021 „next generation vol. 5”

Për vitin e pestë rradhazi, do të zhvillohet konkursi i planeve të biznesit nga qendra “YEA! - Young Entrepreneurs Albania” (www.yea.al) në bashkëpunim me „next generation”. Këtë vit shkollor 2020/21, i gjithë drejtimi dhe organizimi ndodhet në duart e Gernot Scheffknecht (Drejtori i YEA!-s) dhe Ali Nerguti (Koordinator i projektit).

Qëllimi i konkursit të planeve të biznesit („next generation“) është të jetë një komponent i rëndësishëm në kalendarin e aktiviteteve të shkollave profesionale dhe të përgjithshme. Në vitin e kaluar kanë marrë pjesë në finalen e “YEA! Awards 2020, next generation“ 84 nxënës/e nga 10 shkolla të ndryshme.

Krahas përhapjes së mendimit dhe edukimit të sipërmarrjes (Entrepreneurship), ne dëshirojmë që nga kjo iniciativë të mbështesim dhe të zhvillojme jo vetëm mendimin dhe veprimin e sipërmarrjes, por edhe angazhimin, ndërgjegjësimin dhe pergjegjësinë e nxënësëve.

Gjatë bashkëpunimit të suksesshëm me partnerët e projektit kemi arritur të forcojmë vazhdimisht kontaktet dhe kështu, të ndërtojmë një rrjet të qëndrueshem. Konkursi austriak i planeve të biznesit “next generation”, si dhe Ministria e Arsimit e Austrisë mbështesin qëllimin dhe idetë e YEA!-s.

Grupet e synuara të këtij konkursi “target groups”, janë skuadra nxënësish nga gjimnazet dhe shkollat profesionale të interesuara (psh. nga lënda mësimore Ekonomi/Biznes/Sipërmarrje), të cilët i ftojme dhe i motivojmë të marrin pjesë në këtë rrugëtim të konkursit të sivjetshëm të planeve të biznesit YEA!.

Kushtet e pjesëmarrjes:

Në konkursin e YEA! mund të marrin pjesë skuadra nga e gjithë Shqipëria. Çdo skuadër nxënësish ka nga një trajner/e grupi. Skuadrat duhet të regjistrohen direkt në faqen e internetit www.yea.al në linkun “register/krijo nje llogari”. **AFATI: 31 Janar 2021.**



Bundesministerium
Bildung, Wissenschaft
und Forschung



Konkursi i planeve të biznesit do të zhvillohet në dy kategori:

Kategoria I = Sfida e Real Market

„Plani i biznesit/Produkti më i mirë“

Pjesëmarrës të pranueshëm janë vetëm maturantët/et

Në këtë kategori përpunohet dhe vlerësohet plani i biznesit në tregun real. Këtu është i nevojshëm përpunimi i një plan biznesi të kompletuar, i cili do të gjykohet dhe vlerësohet me ndihmën e katalogut të kriterëve.

Pikat/Kriteret e mëposhtme duhen të përgatiten saktësisht:

- Krijimi i një kompanie
- Organizimi i kompanisë (ndërtimi, firma, skuadra)
- Planifikimi i daljes në treg (launch) të produktit (përshkrimi i produktit ose sqarimi i shërbimit)
- Krijimi dhe përgatitja e një plani të detajuar financiar dhe marketingu.
- Krijimi i një produkti/prototipi

max. i faqeve të planit të biznesit: 25 faqe

Kategoria II = Sfida e ideve

„Ideja më e mirë e biznesit“

Pjesëmarrës të pranueshëm janë të gjithë nxënësit/et me përjashtim të maturantëve

Në këtë kategori kërkohet ideja më e mirë e biznesit. Këtu është e nevojshme krijimi i një ideje biznesi të kompletuar, e cila do të gjykohet dhe vlerësohet me ndihmën e katalogut të kriterëve.

Pikat/Kriteret e mëposhtme duhen të përgatiten saktësisht:

- Përshkrimi i idesë së biznesit (përdorimi, përmbajtja inovative)
- Skuadra e sipërmarrjes, si dhe vendosja në zbatim e idesë (implementimi)
- Koncepti i marketingut me të gjitha elementet përkatëse (hulumtimi i tregut, marketingu strategjik dhe operativ)
- Plani i shpenzimeve fillestare (shpenzimet start-up, shpenzimet gjatë një periudhe kohore)

max. i faqeve të idesë së biznesit: 18 faqe



Bundesministerium
Bildung, Wissenschaft
und Forschung



Për të dy kategoritë janë vendosur çmimet përkatëse:

Vendi	Kategoria 1 - Plani i biznesit	Kategoria 2 - Ideja më e mirë	Çmimi special
Skuadrat fituese	€ 350,--	€ 250,--	€ 150,--

Gjithashtu finalistëve nga shkollat, të cilat nuk bëjnë pjesë në qarkun e Shkodrës, por ndodhen në rrethina apo në qytete të tjera, i mbulohen të gjitha shpenzimet e transportit dhe të akomodimit.

Për një vlerësim sa më të drejtë dhe transparent kemi vendosur këto **kritere** për **dy kategoritë**:

Kriteret	Kategoria I	Kategoria II
Elementet kryesore dhe struktura	25 %	15 %
Ideja e biznesit/ Implementimi/ Karakteri inovativ	15 %	30 %
Tregu, Marketingu, Distribucioni	25 %	20 %
Plani i financës/ Shpenzimet start-up/ fillestare	20 %	15 %
Originaliteti (Burimet, ...)	10 %	10 %
Layout (Kriteret formale, design)	5 %	10 %




Bundesministerium
Bildung, Wissenschaft
und Forschung



Përmbledhja e proçesit:

Pjesëmarrësit duhet të kenë kujdes datat e mëposhtme:	Data:
Fillimi i aplikimeve në platformën www.yea.al Ftesë për të gjithë koordinatorët/et, shkollat dhe mësuesit/et (Njoftimi i parë) Fillimi i përpunimeve të planeve të biznesit/ideve të biznesit:	Dhjetor 2020 - Janar 2021
Përfundimi i regjistrimit të skuadrave:	31 Janar 2021
Pasditet e trajnimeve për mësuesit/et dhe nxënësit (Qendrën Rinore Atelie, Shkodër) Për pyetje kontaktoni te faqja: info@yea.al	6 & 20 Shkurt 2021 dhe 6 & 20 Mars 2021
Përfundimi i afatit të dorëzimit të Projekteve:	20 Mars 2021
Gjysmëfinalja e YEA!-s në shkolla; çdo shkollë pjesëmarrëse duhet të zgjedhë skuadrën më të mirë në kategorinë I dhe II Skuadra e organizimit të YEA!s njoftohet për skuadrat fituese të çdo shkolle.	deri më 10 Prill 2021
YEA! Award 2020 - Finalja, shpallja e Fituesve dhe aktiviteti përfundimtar.	E Premte 14 Maj 2021
Takime të mëtejshme:	Data:
Infoworkshop për të sqaruar mësuesit dhe nxënësit mbi YEA! KICK OFF EVENT 2021 „next generation vol. 5”	Infoworkshop #1 - 16 Dhjetor 2020 Infoworkshop #2 - 16 Janar 2021



 Bundesministerium
Bildung, Wissenschaft
und Forschung



Çdo skuadër pjesëmarrëse në konkurset e YEA! AWARD & SUMMIT 2021 do të ketë në dispozicion dokumente dhe shembuj.

Për informacione dhe të dhëna: www.yea.al

YEA! është në gadtshmërinë tuaj për çdo paqartësi, si dhe pret me kënaqësi planet dhe idetë tuaja të biznesit.

Me respekt, stafi YEA!

Gernot Scheffknecht

director@yea.al

Drejtori i YEA!

Ali Nerguti

alinerquti@yea.al

Koordinator projekti

YEA! Young Entrepreneurs Albania

Dream it, love it, DO IT!

069 514 3770

www.yea.al

info@yea.al



Follow us on: [Facebook](#) / [Instagram](#) / [youtube](#)

KUJDES !! - Në qoftë se grumbullimet dhe takimet me shumë persona do të jenë të ndaluara, atëherë Qendra YEA! do ti zhvillojë të gjitha këto takime online